



Pa. nr. 08-07

Komisioni për Mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenin 28 dhe nenin 19 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10 dhe 136/11 dhe 41/14 dhe 53/16),), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Junajted Media S.a.r.l. (UnitedMediaS.à.r.l.), me seli në adresën 16-18 Rue du Strazbur, L-2560 Luksemburg, z. Andrej Iliq (Andrej Ilić), XXX¹ shtetas i Republikës së Serbisë dhe z. Gjorgje Trboviq (Đorđe Trbović),XXX shtetas i Republikës së Serbisë, nëpërmjet Leonid Ristev avokat, nga Shkupi, në seancën e mbajtur me datë 31.01.2017, miratoi

AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi me të cilin Junajted Media S.a.r.l. (UnitedMediaS.à.r.l.), me seli në adresën 16-18 Rue du Strazbur, L-2560 Luksemburg, z. Andrej Iliq (Andrej Ilić), XXX shtetas i Republikës së Serbisë dhe z. Gjorgje Trboviq (Đorđe Trbović),XXX shtetas i Republikës së Serbisë, do të fitojnë kontrollin e përbashkët ndaj shoqërisë tregtare AJDIXHEJDigital Holding Limited (IDJDigital Holding Limited), me adresë në 35/1 Salvu Psaila Strit, Birkirkara, Maltë, nëpërmjet blerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrimin të paguaj takse administrative të njoftimit për përqendrim në shumë prej 6 000,00 den. dhe për vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit të tarifës 28-a të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

¹ Të dhënat paraqesin fshehtësi afariste



Arsyetim

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11, 41/14 dhe 53/16 në datë 21.12.2016, plotësuar më 09.01.2017, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) merr njoftimin për përqendrim me të cilin Junajted Media S.a.r.l. (UnitedMediaS.à.r.l.), me seli në adresën 16-18 Rue du Strazbur, L-2560 Luksemburg, z. Andrej Iliq (Andrej Ilić), XXX shtetas i Republikës së Serbisë dhe z. Gjorgje Trboviq (Đorđe Trbović), XXX shtetas i Republikës së Serbisë, do të fitojnë kontrollin e përbashkët ndaj shoqërisë tregtare AJDIXHEJDigital Holding Limited (IDJDigital Holding Limited), me adresë në 35/1 Salvu Psaila Strit, Birkirkara, Maltë, nëpërmjet blerjes së aksioneve. Në momentin në parashtrim të njoftimit, z. Andrej Iliq dhe z. Gjorgje Trboviq janë anëtarë në AJDIXHEJDigital me 50% të aksioneve të kapitalit.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit të përqendrimit në ditën e pranimi të tij dhe në bazë të dhënave të parashtruara në Njoftimin e përqendrimit dhe anekseve të tij konstatoi si më poshtë:

Junajted Media është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila është e themeluar në mars të vitit 2014, me biznesin e saj të regjistruar që lidhet me televizionin/transmetimin e kanaleve televizive, respektivisht shoqëria konkretisht merret me këshillim, menaxhim dhe furnizim me përmbajtje programore për kompani të ndryshme në kuadër të grupit që merren me prodhim dhe transmetim të përmbajtjeve programore („prodhues të kanaleve”), që pastaj e „paketojnë” përmbajtjen në përputhje të skemës programore në kanal in përkatës, që përmes operatorëve të telekomunikacionit shpërndahet deri të shfrytëzuesit përfundimtarë.

Junajted Media është në pronësi të fondeve që janë të menaxhuara nga shoqëritë të lidhura me shoqërinë KKR & Ko, L.P. (KKR & Co. L.P.), një partneritet i themeluar në Delaver, me seli të regjistruar në 9 Vest Rruga e 57-të, Suit 4200, Nju Jork 10019, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. KKR është një shoqëri globale e investimeve që vepron në mbarë botën. KKR gjithashtu ofron zgjidhje në tregjet e kapitalit për kompanitë, kompanitë e portofolit të saj dhe klientëve të tjerë. Fondet e investimeve të cilët i menaxhon KKR investojnë në kompanitë në një numër të madh të sektorëve.

KKR është e pranishme në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet shoqërisë së varur SBB-Total TV SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Dame Gruev nr. 3 Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë, veprimtaria e të cilës është shpërndarja e përmbajtjeve të medieve nëpërmjet platformës teknike DTH të SBB.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



AJDIXHEJDigital Holding Limited është një kompani holding në Maltë, e cila menaxhon kompanitë AJDIXHEJDigital Holding Limited (IDJDigital Holding Limited), me adresë në 35/1 Salvu Psaila Strit, Birkirkara, Maltë dhe AJDIXHEJWorld d.o.o. Beograd (IDJWorld d.o.o. Beograd), me seli në adresën rrugën Pançevački 36 B, Beograd. Themeluesit e kompanive që janë objekt i transaksionit, paraprakisht **ishin aktiv nën brendin „IDJ” me shpërndarje digjitale**, marketing, plasimin e produkteve dhe zhvillimin e artisteve, kryesisht në drejtim të industrisë së muzikës. Themeluesit ishin aktivë veçanërisht me prodhimin e videove muzikore dhe shpërndarjen digjitale të muzikës dhe videove (duke përfshirë shërbimet siç janë iTunes, AmazonMP3, Spotify, etj), ofrimin e shërbimeve për brende, publikimin e spoteve dhe bashkëpunimin në reklama(psh. Përmes AdWords), respektivisht përfaqësimin dhe promovimin e autoreve të platformave digjitale (psh Deezer, YouTube, Google Play, VEVO, etj).

Në vitin 2016, themeluesit e shoqërisë ngritën edhe AJDIXHEJTV (IDJTV), televizion i specializuar muzikor 24/7 në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi ajo i plotëson kërkesat e nenit 12 (1), pika 2) dhe neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pika 6 (b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës miraton aktvendim ne formë të shkurtuar, Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, është në përputhje me të sepse nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh vlerësimin e këtillë të përqendrimit, Komisioni vendosi ashtu siç parasheh dispozitivi i këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Mjeti juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për nisje të kontestit administrativ në Gjyqin administrativ në Republikën e Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
BLLAGOJ ÇURLINOV